



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

Nr. 14/prot.
4

Tiranë, më 12.02.2026

VENDIM

Nr. 1258, Datë 12.02.2026

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË FACEKOM KORLÁTOLT FELELËSSËGÛ TÁRSASÁG NGA SHOQËRIA 4IG INFORMATIKAI ZÁRTKÖRÛEN MÛKÖDÖ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 12.02. 2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përfitim të kontrollit të shoqërisë FaceKom Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Informatikai Zártkörűen Működő Részvénytársaság.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfimit të kontrollit të shoqërisë FaceKom Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Informatikai Zártkörűen Működő Részvénytársaság,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi përftimin e kontrollit të shoqërisë FaceKom Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Informatikai Zártkörűen Működő Részvénytársaság.
2. Referuar dokumentit "Kontratë shitblerjeje e pjesës së aksioneve të biznesit", palët në marrëveshje janë:
3. **Blerësi: 4iG Informatikai Zártkörűen Működő Részvénytársaság (4iG Informatikai Zrt.)** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë, e cila fokusohet në teknologjinë e informacionit dhe integrimin e sistemeve për klientët. Ajo ofron dizajnin e sistemeve IT, zgjidhje të plotë për infrastrukturën digjitale, zhvillim të softuerëve kompleks, mbështetje për shërbimet IT dhe mbështetje për iniciativa të transformimit digjital.
4. Kjo shoqëri është pjesë e grupit 4iG, i cili është prezent në Shqipëri nëpërmjet shoqërisë ONE ALBANIA SHA, shoqëri aksionare, me objekt aktiviteti: ndërtimin, zotërimin, operimin dhe ofrimin e rrjetit publik të telefonisë së lëvizshme të standardit GSM dhe telefoni fikse, komunikimi bazë i telefonisë celulare në rrjetin lokal bazuar në kanalet radio, komunikim bazë në rrjetin ndërqytetas që lidhen me transmetimin radio, komunikim ndërkombëtar të çdo lloj transmetimi dhe vale, komunikimi i të dhënave në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, komunikim multimedia dhe ISDN, komunikim teleteks dhe videotekst, etj.
5. **Shitësi: Central European Opportunity Magántőkealap** është një fond kapitali privat, i regjistruar pranë Bankës Kombëtare të Hungarisë.
6. **Shoqëria Target: FaceKom Korlátolt Felelősségű Társaság (FaceKom Kft.)** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë, veprimtaria kryesore e së cilës përfshin identifikimin digjital të klientëve, të realizuar në distancë nëpërmjet teknologjisë video dhe njohjes së fytyrës, si dhe shërbime të lidhura me pranimin e klientëve dhe shërbime virtuale call-center. FaceKom Kft. është në pronësi të plotë të Central European Opportunity Magántőkealap.
7. FaceKom Kft. zotëron plotësisht filialin e saj FaceKom Services Zártkörűen Működő Részvénytársaság, shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë, e cila operon si një ofrues i shërbimeve të besueshme për nënshkrimet elektronike.
8. Shoqëria target nuk operon dhe nuk gjeneron xhiro në Shqipëri.

II. Përqendrimi

9. Më datë _____ ndërmjet shoqërisë 4iG Informatikai Zártkörűen Működő Részvénytársaság (në cilësinë e blerësit) dhe shoqërisë Central European Opportunity Magántőkealap (në cilësinë e shitësit), është nënshkruar "Kontratë shitblerjeje e pjesës së aksioneve të biznesit" për shitblerjen e pjesës së kuotës që përfaqëson _____ % të kapitalit themeltar të shoqërisë FaceKom Korlátolt Felelősségű Társaság.




10. Sipas Marrëveshjes, Shitësi synon të shesë dhe t'i transferojë Blerësit, pjesën e kuotës që përfaqëson % të kapitalit themeltar të shoqërisë target FaceKom Kft., ndërsa blerësi synon të blejë dhe të pranojë pjesën e kuotës, në përputhje me kushtet e parashikuara në kontratë.
11. Pas përmbylljes të transaksionit, 4iG Informatikai Zrt. do të zotërojë plotësisht shoqërinë FaceKom Kft. dhe gjithashtu do të fitojë kontrollin mbi shoqërinë filial FaceKom Services Zártkörűen Működő Részvénytársaság.
12. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë FaceKom Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Informatikai Zártkörűen Működő Részvénytársaság, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

13. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 "Për përcaktimin e tregut përkatës", treg përkatës do të konsiderohet tregu i ofrimit të zgjidhjeve të sigurta për verifikimin dhe autentifikimin digjital të identitetit, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
14. Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë FaceKom Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Informatikai Zártkörűen Működő Részvénytársaság.
15. Shoqëria 4iG Informatikai Zrt. është një shoqëri aktive në sektorin e IT-së, duke u fokusuar në teknologjinë e informacionit dhe integrimin e sistemeve për klientët, pjesë e Grupit 4iG.
16. Grupi 4iG është prezent në Shqipëri nëpërmjet shoqërisë ONE ALBANIA SHA, një shoqëri aktive në tregun e komunikimeve elektronike.
17. Shoqëria FaceKom Kft. është një shoqëri aktive në ofrimin e identifikimit digjital të klientëve në distancë, bazuar në njohjen e fytyrës përmes video, si dhe shërbimeve të lidhura për onboarding të klientëve dhe qendra virtuale të thirrjeve.
18. Target nuk operon dhe nuk gjeneron xhiro në Shqipëri.
19. Transaksioni i propozuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar. Ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës",



VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përfitim të kontrollit të shoqërisë FaceKom Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Informatikai Zártkörűen Működő Részvénytársaság.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja "Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Leida MATJA  Zv/Kryetar	Rezana KONOMI  Anëtar	Durim KRAJA  Anëtar	Fatjola DELIJA  Anëtar
--	--	---	---



Denar BIBA

Kryetar